



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1683 Prot.

Tiranë, më datë 13.12.2021

VENDIM
Nr. 667, datë 10.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 10.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit me objekt “Ndryshim projektit pranë këmbëve të urës së Goricës”, në kuadër të miratimit të projektit të zbatimit “P01 – Restaurimi i peizazhit historik urban të Lagjes Goricë”, brenda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Beratit, me Vendim Nr. 133, datë 12.03.202, aplikues z. Dhimitraq Niko (DRTK Berat), zhvillues Bashkia Berat;
2. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkuara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

